



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Data: 11.4.2023

Nr: 308

Ora: 19:00

**VENDIM**

**PËR**

**EMËRIM TË ANËTARËVE TË KZAZ-SË NR. 81, BASHKIA LIBOHOVË, KZAZ-SË NR. 28, BASHKIA  
KAMËZ, TË PROPOZUAR NGA PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, PËR ZGJEDHJET PËR  
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 7 të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë me shkresën nr. 3583 prot., datë 7.4.2023 ka kërkuar emërimin e dy anëtarëve në KZAZ-në nr. 81, Bashkia Libohovë dhe një anëtarin në KZAZ-në nr. 28, Bashkia Kamëz.

Pas kryerjes së verifikimit të dokumentacionit, me plotësim të tij, dhe verifikimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezultojnë që propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: 11.4.2023 Nr: 308  
Ora: 19:00



“Për emërim të anëtarëve të KZAZ-së nr. 81, Bashkia Libohovë, KZAZ-së nr.28, Bashkia Kamëz, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

## V E N D O S:

1. Emërimin e anëtarëve të KZAZ-së nr. 81, z. Arsen Qamil Çobani, z. Sajmir Agim Meçani, Bashkia Libohovë, e anëtarit të KZAZ-së nr. 28, z. Urim Sali Gjurra, Bashkia Kamëz, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**